



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 4836 prot.

Shkodër, më 02.03. 2026

VENDIM

Nr. 11, datë 27.02.2026

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR, PËR AKORDIMIN E NDIHMËS
FINANCIARE PËR FAMILJET E MEDI GJELAJ DHE ALBAN JALIQ, BANESAT E
TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27.02.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar; si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër”, dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin tekniko-ligjor të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare për familjen e Medi Gjellaj, me 4 (katër) anëtarë, në vlerën 80,000 (tetëdhjetë mijë) lekë, për dëmtimin e banesës nga zjarri, sipas certifikatës familjare të paraqitur.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar për familjen e Medi Gjellaj, sipas të cilit vlera e dëmit nga ana ndërtimore është 346,481 (treqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e një) lekë dhe vlera e dëmeve në orëndi dhe pajisje është 348,780 (treqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve pranë Bashkisë Shkodër.

3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare për familjen e Alban Jaliq, me 5 (pesë) anëtarë, në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, për dëmtimin e banesës nga zjarri, sipas certifikatës familjare të paraqitur.
4. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar për familjen e Alban Jaliq, sipas të cilit vlera e dëmit nga ana ndërtimore është 0 (zero) lekë dhe vlera e dëmeve në orendi dhe pajisje është 114,500 (njëqind e katërbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve pranë Bashkisë Shkodër.
5. Burimi i financimit për ndihmën e menjëhershme financiare, në vlerën totale 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, të jetë fondi i emergjencave civile, i parashikuar në Programin AB141 “Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile”, Q2 O1 A5 “Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2026, miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e kësaj ndihme.
6. Kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore, si dhe i dëmeve në orendi dhe pajisje për familjet e Medi Gjellaj dhe Alban Jaliq, do të bëhet sipas preventivave të hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, pikës 3 të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 dhe pikës 3.1/a të VKM nr. 414, datë 08.07.2021, i ndryshuar, sipas relacionit bashkëlidhur, në masën 50% të vlerës së dëmit ndërtimor në shumën 173,241 (njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e një) lekë dhe në masën 50% të vlerës së dëmeve në orendi në shumën 231,640 (dyqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë, pas akordimit të fondeve përkatëse nga Ministria e Mbrojtjes.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 38 vota

Vota Pro	38
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	02.03.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj


